

POLICA E SIGURIMIT HULL
(Sigurimi i Trupit të Mjetit Lundrues HULL)

1. KUSHTET E SIGURIMIT

1.1 Këto klauzola, së bashku me Çertifikatën e Sigurimit dhe çdo shtojcë të aplikuar, përbëjnë kushtet e përgjithshme për të cilat Siguruesi ka rënë dakord për të siguruar Mjetin Lundrues – sipas përacktimit të Kodit detar. Këto dokumente do të lexohen të gjitha së bashku si një e tërë.

2. OBJEKTI I SIGURIMIT

2.1 Kontrata e sigurimit të Mjetit Lundrues mbulon dëmtimin fizik të trupit të Mjetit Lundrues të shkakuar nga zjarri, shpërthimi, vjedhja dhe rreziqe të tjera detare. Ai gjithashtu mbulon dëmtimin e makinerive dhe pajisjeve dhe aparatave të tjera të instaluar në Mjetin Lundrues. Shuma e dëmshpërblimit do të jetë deri në Shumën e Siguar.

3. DËMI FIZIK

3.1 Jahti Mjeti Lundrues sigurohet deri në vlerën e deklaruar në Çertifikatën e Sigurimit kundrejt të gjithë rreziqeve të humbjeve apo dëmtimeve fizike që shkaktohen nga aksidente që përfshijnë edhe vjedhjen, defekte të trashëguara apo veprime neglizhente apo të qëllimshme të çdo personi të tretë, me kusht që këto veprime neglizhente apo të qëllimshme si edhe humbjet apo dëmet që lindin prej tyre do të ndodhin gjatë periudhës së mbuluar nga ky siguracion, subjekt i përjashtimeve dhe përcaktimeve të vendosura në seksionet e mëposhtëm të këtyre Klauzolave.

3.2 Nëse, si rezultat i një ngjarjeje të siguar, Mjeti Lundrues ka humbje totale apo është dëmtuar aq shumë sa kostot për ta kthyer në gjendjen e mëparshme apo të riparimit të tij do të kalonin vlerën e deklaruar në Çertifikatën e Sigurimit, Siguruesi do të paguajë vlerën e deklaruar në Çertifikatën e Sigurimit ose, nëse Siguruesi vendos ndryshe, do ta zëvendësojë atë me një mjet të ngjashëm të të njejtit tip dhe në kushte të njejtë.

3.3 Në rast se Mjeti Lundrues është dëmtuar si rezultat i një ngjarjeje të siguar, Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të riparimit të tij ose, nëse Siguruesi vendos ndryshe, do të zëvendësojë çdo pjesë të veçantë të humbur apo dëmtuar me një tip të ngjashëm me kushte të njejtë.

3.4 Përgjegjësia totale që lind nga një ngjarje e siguar, në asnjë rast nuk do të kalojë një shumë të barabartë me vlerën e Mjetit Lundrues të deklaruar në Çertifikatën e Sigurimit për:

- Kostot e arsyeshme të shpëtimit të Mjetit Lundrues (përveç shërbimeve të shpëtimit që bëhen nga një anije tjetër me të njejtin pronar apo menaxhim).

- Kostot e arsyeshme për heqjen e mbeturinave të Mjetit Lundrues prej vendit nga i cili i Siguruari bëhet ligjërisht i detyruar ta lëvizë atë dhe shpenzimet e arsyeshme për zhvendosjen e Mjetit Lundrues të mbytur.

- Shpenzimet e arsyeshme për të inspektuar fundin e Mjetit Lundrues pas rënies në cekinë, nëse kryhen në mënyrë të arsyeshme si rezultat i kësaj rënieje në cekinë, gjithashtu edhe nëse nuk është gjetur asnjë dëmtim.

4. PËRJASHTIME QË LIDHEN ME SEKSIONIN DËME FIZIKE

4.1 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesat për dëmshpërblim në rastet si vijon:

4.1.1 Për çdo humbje apo dëm që shkaktohet nga mosushtrimi i domosdoshëm i menaxhimit të Mjetit Lundrues siç duhet apo mosmbajtja e tij në kushte të përshtatshme lundrimi ndërsa është për faj të të Siguararit, kapitenit të Mjetit Lundrues apo i ndonjë personi tjetër të caktuar nga i Siguruari për të menaxhuar Mjetin Lundrues.

4.1.2 Për çdo humbje apo dëm të shkakuar me qëllim nga i Siguruari apo nga çdokush në bordin e Mjetit Lundrues me lejen e të Siguararit.

4.1.3 Për çdo humbje apo dëmtim të shkakuar nga vjetrimi, korrozioni, sjellja e brendëshme, mikrobet apo dëmet nga ngrirja.

4.1.4 Për shpenzimet e riparimit ose zëvendësimit të çdo pjese të Mjetit Lundrues që ka rezultuar me defekt latent (megjithatë Siguruesi do të paguajë për dëme të shkaktuara në pjesën tjetër të Mjetit Lundrues nga dëmtimi i papritur dhe i menjëhershëm i kësaj pjese).

4.1.5 Për vjedhje apo lëvizje të paautorizuar të Mjetit Lundrues nga çdokush i cili kontrollon atë pa lejen e të Siguararit përveç kapitenit profesionist apo ekuipazhit.

4.1.6 Për vjedhje të çdo motori jashtëbordi i cili në kohën kur ndodh vjedhja ishte i braguar në Mjetin Lundrues dhe ka shenja të dukshme të lëvizjes me forcë ose brenda një kabine apo depoje të kyçur në të cilin ka shenja të dukshme të hyrjes me forcë.

4.1.7 Për vjedhje të çdo pjese apo pajisjeje të Mjetit Lundrues, përveç kur në kohën e vjedhjes pjesa ishte brenda kabinës apo një kompartamenti të kyçur, në bord, në të cilin ka shenja të dukshme të hyrjes me forcë.

4.1.8 Për vjedhje të çdo varke apo motorskafi shërbimi në Mjetin Lundrues, përveç kur është regjistruar me emër dhe numër regjistrimi të veçantë.

4.1.9 Për pjesën e zbritëshme të cilësuar në Çertifikatën e Sigurimit në lidhje me çdo një apo seri humbesh që lindin nga çdo një apo seri ngjarjesh.

4.1.10 Për humbje dhe dëme nga rimorkimi.

4.1.11 Për humbje ose dëme në mbulesat mbrojtëse apo tek pëlhurat e velave shkakuar nga era.

4.1.12 Për humbje apo dëme që lindin ndërsa Mjeti Lundrues ka marrë pjesë në gara apo prova që lidhen me to.

4.1.13 Për humbje apo dëme që rezultojnë nga motori fuoribord i cili i bashkangjitet apo vihet mbi bord, nëse fuqia e motorit është llogaritur nga prodhuesi të jetë mbi 65 kuaj-fuqi.

4.1.14 Për humbje apo dëme ndërsa Mjeti Lundrues është në kontrollin e një personi i cili, sipas njohurive dhe fakteve, ndodhet nën ndikimin e pijes apo alkoolit.

4.1.15 Për humbje apo dëme që rezultojnë nga zjarri apo eksplozioni në bordin e Mjetit Lundrues i cili ka një dhomë motorri apo hapsirë për motorrin, përveç kur dhoma apo hapësira e motorrit është e pajisur me sistem automatik për fikjen e zjarrit, apo sistem zjarrfikës që komandohet në pozicionin e drejtimit apo jashtë dhe bashkangjitur dhomës apo hapsirës së motorrit. Është kusht i këtij sigurimi që ky sistem i shuarjes së zjarrit të jetë i çertifikuar, të instalohet siç duhet, të mbahet në gjendje pune dhe t'i bëhet shërbim rregullisht në përputhje me rekomandimet e prodhuesit.

4.1.16 Për humbje apo dëme në timon, aks apo helikë, përveç kur shkaktohet nga kontakti me anije tjetër, një bankinë apo mol ose kur Mjeti Lundrues është mbytur apo fundosur në rrethana të cilat nuk janë të përjashtuara.

4.1.17 Për dëme të shkakuar nga apo që lindin kur Mjeti Lundrues takon në cekinë, mbytet, zhytet apo përplasat ndërsa rimorkiohet.

4.1.18 Për dëme të shkakuar gjatë akostimit në vende që nuk janë të përshtatshme për këtë qëllim.

4.1.19 Për dëme të shkaktuara nga akte terroriste direkte apo indirekte dhe dëme si pasojë e luftës.

4.1.20 Për dëme që vijnë nga fitimi munguar.

5. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

5.1 Pyetëtori që plotëson dhe firmos i Siguruari apo agjenti ose menaxheri përbën bazën e kontratës midis tij dhe Siguruesit. I

Siguruari garanton saktësinë e informacionit të deklaruar në pyetësor. Nëse ndonjë pjesë e informacionit është e pavërtetë apo e padeklaruar, Siguruesi ka të drejtë të ndërpresë këtë siguracion që prej fillimit të tij.

6. LUNDRIMI DHE PËRDORIMI

6.1 Mjeti Lundruer është i mbuluar me sigurim ndërsa lundron brenda kufijve të deklaruar në Çertifikatën e Sigurimit, ndërsa është i ankoruar dhe rimorkjuar duke përfshirë ngritjen në shkallë apo lëshimin, ndërsa është duke lëvizur brenda dokut, gjatë pajisjes, përshtatjes, ripajisjes, kontrollit teknik, gjatë kryerjes së mirëmbajtjes apo survejimit special, por jo ndërsa është duke u perdorur për banim apo gjatë riparimeve të përgjithshme apo ndryshimeve. Timoni dhe pajisjet janë të mbuluara ndërsa ndodhen apo jo në bord të anijes, gjatë transportit nga vendi i ruajtjes në tokë apo ndërsa janë në vendin e ruajtjes në tokë.

7. PERIUDHA

7.1 Ky siguracion është i vlefshëm për periudhën e treguar në Çertifikatën e Sigurimit por në asnjë rast ky sigurim nuk do të jetë i vlefshëm kur ka përfunduar afati i Lejes së Lundrimit.

8. TRANZITI

8.1 Jahti (Mjeti Lundruer) është i mbuluar me sigurim ndërsa transportohet në rrugë tokësore, hekurudhë, traget apo rrugë ajrore, transport i cili fillon dhe mbaron në tokë, brenda kufijve gjeografikë të deklaruar në Çertifikatë dhe gjatë ngarkim shkarkimit.

8.2 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesë për dëmshpërblim që lind gjatë transportit për gërvishje, dalje boje apo çpime apo për çdo përgjegjësi për palët e treta. Nëse gjatësia e përgjithshme e Mjetit Lundruer është më shumë se 8.53 m, mbulimi me sigurim përfshin 16 km gjatësi rrugë tokësore dhe çdo transport do të kryhet nga një transportues profesionist, përndryshe nuk do të paguhet asnjë humbje apo dëm gjatë transportit.

9. PËRDORIMI PRIVAT

9.1 Mjeti lundruer duhet të përdoret vetëm për qëllime private dhe në drejtimin e tij duhet të ketë persona kompetentë të njohur dhe licencuar dhe me miratim të të Siguararit. Mjeti lundruer nuk do të përdoret me qera apo hua, përveç kur është rënë dakord më parë që do të përdoret për qëllime të tjera dhe Siguruesi ka rënë dakord të paguajë primin shtesë që kërkohet.

9.2 Nëse bihet dakord me aprovim dhe te siguruesit që Mjeti Lundruer mund të përdoret, jepet hua apo me qera, Mjeti Lundruer duhet që gjatë gjithë kohës të jetë nën mbikqyrje nga një person i kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme dhe duhet që gjatë gjithë kësaj kohe të jetë nën komandën e një personi kompetent.

10. PËRDORIMI NË LUNDRIM NGA NJË DORË

10.1 Mjeti Lundruer duhet që të lundrojë vetëm midis orëve nga lindja e diellit deri në perëndim dhe vetëm për një total prej 50 milje në ditë, përveç rastit kur drejtohet të paktën nga dy persona të fortë fizikisht ku të paktën njëri është kompetent për të komanduar anijen.

11. NDRYSHIMI I PRONËSISË

11.1 Ky siguracion do të ndërpritet menjëherë automatikisht me ndryshimin e pronësisë, ose nëse i Siguarar është Kompania apo Korporata, ndryshimi në kontrollin e Kompanisë apo Korporatës do të sjellë ndryshim të përfuturit ligjor.

12. VAZHDIMËSIA E SIGURIMIT

12.1 Nëse Mjeti Lundruer është në lundrim kur përfundon siguracioni, mbulimi do të vazhdojë automatikisht derisa anija të

prekë portin tjetër, me kusht që i Siguruari të njoftojë Siguruesin jo më vonë se 24 orë përpara datës së përfundimit dhe të pranojë të paguajë një prim për rinovimin ose për sigurimin e periudhës shtesë.

13. KUJDESI I DUHUR

13.1 I Siguruari dhe Menaxherët e tij (nëse ka) duhet që gjithë kohën të ushtrojnë kujdesin e duhur për të mbajtur Mjetin Lundruer në kushte të përshtatshme për lundrim, të shikojnë që është pajisur siç duhet me të gjitha mjetet e sigurisë dhe t'i ruajë ato pajisje në gjendje të mirë pune si edhe të sigurohet që kur lihet pa ruajtje Mjeti Lundruer të jetë braguar mirë, që lokalet e akomodimit dhe të depozitimit janë të siguruara dhe të mbyllura si dhe të parandalojë ndotjen apo rrezikun e ndotjes si pasojë e dëmtimit të Mjetit Lundruer.

13.2 Nëse ndodh ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të marrë të gjitha masat e duhura që varen prej tij apo nga ai për të shpëtuar dhe ruajtur pasurine e siguruar me qëllim që të ndalohej shtimi dëmit apo realizohet pakesimi i dëmit. Siguruesi nuk detyrohet të paguajë shpërblim për atë pjesë të dëmit që u shkaktua nga mosmarrja prej të siguararit të masave që mund të merreshin prej tij për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinën e siguruar. Masa të duhura përfshijnë por nuk përjashtojnë të tjera si njoftimi i organeve të shpëtimit, policisë dhe zjarrfikësve, karroatrec detar për shpëtimin e Mjetit Lundruer, nxjerrjen e pajisjeve dhe makinerive të Mjetit Lundruer, përdorimi i fikseve të zjarrit etj.

14. MBISIGURIMI DHE NËNSIGURIMI

14.1 Nëse për Mjetin Lundruer është deklaruar një vlerë më e madhe se ajo e vlerës së tij në treg, vlera e dëmshpërblimit do të limitohet deri në vlerën reale të Mjetit Lundruer në treg.

14.2 Kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vlera e pasurisë së siguruar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjestim me raportin midis shumës së siguruar dhe vlerës së pasurisë të siguruar.

15. LIGJSHMËRIA

15.1 Është kusht i këtij sigurimi që i Siguruari, dhe çdokush në komandën e Mjetit Lundruer, të jetë në përputhje me çdo ligj që ka lidhje me të, të sigurohet që Mjeti Lundruer i përgjigjet çdo rregull ligjor të aplikueshem dhe fiton çdo leje apo licensë të kërkuar me ligj, në çdo vend që ka juridiksion mbi ujrat në të cilat Mjeti Lundruer lundron.

16. E RE PËR TË VJETËR

16.1 Siguruesi, sipas opinionit të tij, në rast të kërkesës për dëmshpërblim për zëvendësim të velave, mbulesave mbrojtëse, cimave apo motorëve jashtë bordit me vlerë më të madhe se dy të tretat e vlerës të secilës pjesë, mund t'i propozojë të Siguararit të marrë një pjesë të re në vend të së vjetrës.

17. PROCEDURA E KËRKESËS PËR DËMHPËRBLIM

17.1 Mosqenia në përputhje me kushtet e kësaj klauzole mund të paragjykojë kërkesën për dëmshpërblim.

17.2 Nëse një ngjarje bën të lindë një kërkesë për dëmshpërblim sipas çdo Seksioni të këtij siguracioni, i Siguruari duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e arsyeshme SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

17.3 Në rast vjedhjeje apo dëmi keqdashës i Siguruari duhet të njoftojë policinë lokale dhe autoritetet portuale sa më shpejt të jetë e mundur. Ky mbulim nese nuk është specifikuar ndryshe është i vlefshem vetem nese është pajisur me GPS.

17.4 I Siguruari duhet të marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të ndaluar apo për të minimizuar çdo humbje që do të ishte e

dëmshpërblyeshme sipas këtij siguracioni dhe të minimizojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

17.5 Por edhe nëse i Siguruari bën të kundërtën, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar për të dëmshpërblyer për operacionet e shpëtimit apo përgjegjësi të tjera. Si shtesë e shumë s të paguar sipas këtij sigurimi, Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të çdo hapi që i Siguruari do të marrë dhe që në përputhje me detyrimet e tij sipas Klauzolës 3.4 nuk kalojnë vlerën e Mjetit Lundrues/shumën e sigurimit.

17.6 Shpenzimet për mbrojtjen gjyqësore si edhe shpenzimet që bëhen nga i Siguruari për kundërshtimin e përgjegjësisë nuk mbulohen.

17.7 I siguruari duhet të bashkëpunojë plotësisht me Siguruesin për të siguruar informacionin dhe dëshmitë e duhura, dhe duhet të lejojë Siguruesin që të procedojë në emër të tij (por me shpenzimet e Siguruesit) për të fituar dëmshpërblim nga ndonjë palë e tretë në lidhje me mbulimet sipas këtij siguracioni.

17.8 Nëse i Siguruari bën një kërkesë për dëmshpërblim, apo deklaratë që ka lidhje me dëmshpërblimin, për të cilën Siguruesi ka dijeni që është fallco apo mashtruese, apo kur i Siguruari nuk furnizon me informacion në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, ky siguracion do të bëhet i pavlefshëm që prej fillimit të tij dhe do të mbahet i gjithë primi i paguar.

18. E DREJTA E ZËVENDËSIMIT DHE REGRESIT

18.1 Siguruesi që ka paguar shumën e dëmshpërblimit zë vendin e të siguruarit dhe ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumave të paguara nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

19. NJOFTIME DHE GJYKATA KOMPETENTE

19.1 Nëse kërkesa për dëmshpërblim është për koston e riparimit, i Siguruari duhet të sjellë të paktën dy kuotime për këto riparime.

19.2 Kërkesa për dëmshpërblim do të paguhet vetëm pasi të jetë bërë riparimi dhe i Siguruari ka bërë deklaratën e pranimit të vlerës.

19.3 Çdo njoftim i Siguruari duhet ta japë të SIGAL Uniqa Group Austria sh.a. në adresën zyrtare.

19.4 Përveç kur shprehet ndryshe në Çertifikatë, ky siguracion do të funksionojë në përputhje me ligjin Shqiptar. Përveç kur shprehet ndryshe në Çertifikatë, kjo kontratë sigurimi është në varësi ekskluzive të juridiksionit të Gjykatës Shqiptare.

20. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

20.1 I siguruari është njohur me deklaratën e privatësisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. në cdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara në Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

21. E DREJTA E INFORMIMIT

21.1 I siguruari ka të drejtën të informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nëpërmjet

telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të përdorura nga shoqëria.

21.2 I siguruari dhe/ose Policëmbajtësi janë informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhenat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, rreziqet e mbuluara dhe të perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe mënyra e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe cdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

22. E DREJTA E TË SIGURUARIT PËR TU ANKUAR

22.1 I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se cmojne se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim në adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do të përgjigjet çdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve të percaktuara në ligj.

22.2 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate është në varësi ekskluzive të juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe i zbatueshem është Legjislacioni Shqiptar.

22.3 Nënshkrimet e palëve në policën e sigurimit vërtetojnë se kanë rënë dakort me informacionin e dhënë paraprakisht, kanë lexuar dhe kuptuar të gjitha termat dhe kushtet e kësaj kontrate sigurimi, dhe pranojnë me vullnet të lirë t'i respektojnë e zbatojnë ato. Këto kushte janë njohur dhe pranuar për tu respektuar dhe zbatuar nga përfituesi i kësaj kontrate i cili është dhe mbajtës i kontratës.

23. KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

23.1 Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzolë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor."

23.2 Nënshkrimet e palëve në policën e sigurimit vërtetojnë se kanë rënë dakort me informacionin e dhënë paraprakisht, kanë lexuar dhe kuptuar të gjitha termat dhe kushtet e kësaj kontrate sigurimi dhe shprehin dakordësi në mënyrë të veçantë edhe për gjithë seksionin "Dëmi Fizik" dhe seksionin "Përrjashtime që lidhen me seksionin Dëme Fizike", dhe pranojnë me vullnet të lirë t'i respektojnë dhe zbatojnë të gjitha kushtet e kontratës. Këto kushte janë njohur dhe pranuar për tu respektuar dhe zbatuar nga i siguruari/përfituesi i kësaj kontrate i cili është dhe mbajtës i kontratës.